



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura III

Nr. 2

Prishtinë, më 13.02.2008, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës,

salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Gani Koci, Haki Shatri, Safete Hadergjonaj, Hajdin Abazi, Armend Zemaj, Myrvete Pantina, Xhevdet Neziraj, Besa Gaxherri, Kosara Nikolić, Müfera Şinik.

Anëtarët që munguan: Behxhet Pacolli, Driton Tali.

Të pranishëm ishin edhe : z. Bedri Hamza, zv.Ministër për Ekonomi dhe Financa , z. Agim Krasniqi, Drejtor i Buxhetit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, monitorues nga USAID, OSCE, KDI.

Nga Sekretaria e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sekretar i Kuvendit, Natasa Prica-Tisma, Zyrtare e lartë ligjore, Arta Hajra, Zyrtare ligjore, Vilson Ukaj, Zyrtar ligjor.

Kryesues: Gani Koci, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës

- 1. Miratimi i rendit të ditës.**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2008.**

4. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të organizatave buxhetore në vijim:
 - 4.1. Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit
 - 4.2. Zyra e Rregullatorit të Energjisë
 - 4.3. Agjencioni Kosovar kundër Korrupsionit
 - 4.4. Këshilli Gjyqësor i Kosovës
 - 4.5. Instituti Gjyqësor i Kosovës
 - 4.6. Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina
 - 4.7. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
 - 4.8. Komisioni i Pavarur për Media
 - 4.9. Agjencia Pyjore e Kosovës
 - 4.10. Institucioni i Ombudspersonit
 - 4.11. Ministria për Komunitete dhe Kthim
 - 4.12. Zyra për komunitete e komunës së Zveçanit
 - 4.13. Ministria për Tregti dhe Industri
 - 4.14. Ministri për Punë të Brendshme
 - 4.15. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari hapi mbledhjen dhe propozoi rendin e ditës për këtë mbledhje. Ai propozoi që rendi i ditës të plotësohet edhe me pikën. **4.16. Shqyrtimi i kërkesës për projektet kapitale për vitin 2008 të Kuvendit të Kosovës.**

Kryetari vuri në votim propozimin e plotësuar të rendit të ditës. Ai konstatoi se rendi i ditës u miratua si i tillë i propozuar.

Kryetari hapi për shqyrtim pikën e dytë të rendit të ditës

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Pasi që nuk pati komente lidhur me procesverbalin, përveç vërejtjes së znj. Kosara Nikolić se në procesverbal emri i saj nuk figuron te të pranishmit dhe kërkesës të përmirësohet ky lëshim, u miratua procesverbali nga mbledhja e kaluar dt. 6.02.2008.

Kryetari hapi për shqyrtim pikën e tretë të rendit të ditës

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2008.

Kryetari njoftoi të pranishmit në mbledhje me kërkesën e Qeverisë, respektivisht të Kryeministrit Thaçi drejtuar Kryetarit të Kuvendit që Projektligji për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2008 të shqyrtohet dhe miratohet në procedurë të përshpejtuar. Pasi që Buxheti i Konsoliduar për vitin 2008 nuk është miratuar në afat të rregullt ligjor për shkak të zgjedhjeve të mbajtura dhe formimit të institucioneve të reja, PSSP-ja përmes një udhëzimi administrativ 2007/14 ka autorizuar shpenzimin e mjeteve buxhetore për të gjitha organizata buxhetore për muajin janar dhe shkurt. Mirëpo koha e shkurtër e mbetur në dispozicion kërkon një procedurë të përshpejtuar të shqyrtimit dhe miratimit të Buxhetit të Konsoliduar për vitin 2008, e kjo gjithashtu për shkak të rrethanave objektive të cilat priten të zhvillohen ditëve në vijim në Kosovë dhe angazhimit që do të kenë institucionet e Kosovës, sidomos Kuvendi dhe Qeveria në këtë proces.

Kryetari ia kaloi fjalën zv.ministrit për Ekonomi dhe Financa për të shpjeguar dhe sqaruar Projektligjin e propozuar nga Qeveria.

Zv. Ministri për Ekonomi dhe Financa z. Bedri Hamza njoftoi të pranishmit se gjatë procesit të rishikimi të Buxhetit nga propozimi i përcjellë nga Qeveria e mandatit të kaluar, janë bërë disa ndryshime të cilat mund të vërehen si rritja e të hyrave nga doganat për rreth 18 milion euro. Po ashtu edhe të dalurat buxhetore kanë pësuar ngritje dhe në tërësi paraqesin shumën prej 1 miliardë e 196 milion euro. Ngritje të shumave ka edhe te pozicioni i pagave, kjo për arsye të përfshirjes së numrit të deputetëve pasivë, të cilat kanë qenë në mandatin e kaluar të Kuvendit të Kosovës kurse në mandatin e tanishëm nuk e kanë mandatin e deputetit, zëvendës ministrit apo të ministrit dhe të cilëve ligji ua siguron kompensimin për një kohë të caktuar. Kjo kategori e shpenzimeve është futur te pagat dhe mëditjet dhe paraqet ngritje prej 1.200.000 euro. Ngritje ka edhe në pozicionet mallra e shërbime dhe subvencione e transfere, si dhe te investimet kapitale. Te shpenzimet kapitale ngritja në total shënon për 12.400.000 euro, edhe pse më shumë është bërë ndryshim në strukturën e projekteve kapitale.

Për dallim nga projekti i qeverisë së kaluar, në këtë projekt buxhet të hyrat si në nivelin qendror edhe atë lokal të cilat janë kontraktuar vitet e kaluara por nuk janë pashpenzuar, do të shfrytëzohen këtë vit, mirëpo janë paraqitur ndaras nga mjetet e ndara në këtë vit. Kjo paraqet 29 milion euro për nivelin qendror kurse për nivelin komunal 27 milion euro.

Zv.ministri bëri të ditur për komisionin se Qeveria e tanishme i ka marrë parasysht të gjitha kërkesat buxhetore të organizatave buxhetore të cilat i kanë paraqitur pranë Qeverisë dhe ato të domosdoshme janë përfshirë në projekt buxhet. Kurse për shkak të kohës së shkurtër që ka pasur në dispozicion qeveria, kërkesat tjera që nuk janë realizuar do të merren parasysht gjatë vitit në procesin e rishikimit buxhetor. Ai përsëriti kërkesën e Qeverisë që duke pasur parasysht arsyet të cilat kanë shtyrë aprovimin e buxhetit nga Kuvendi sipas afateve ligjore, që është dashur të ndodh në dhjetor të vitit të kaluar, e që ishin zgjedhjet parlamentare dhe lokale në Kosovë si dhe formimi i institucioneve të reja, të aprovohet Buxheti i Konsoliduar për vitin 2008 në procedurë të përshpejtuar. Kjo me qëllim që të mos vijë deri te ngecjet në realizimin e buxhetit sidomos në projektet kapitale.

Kryetari ftoi për diskutim anëtarët e Komisionit.

Kryetari bëri të ditur se situata aktuale dhe kërkesa e Qeverisë për procedim të shpejtë të Projekt Buxhetit për vitin 2008 e ka vënë Komisionin në një pozitë paksa të papërshtatshme, pasi që për projektligjin e propozuar deputetëve iu ka mbetur shumë pak kohë për analizë dhe shqyrtim të mirëfilltë që kërkon një çështje kaq e rëndësishme për çdo shtet. Ai deklaroi se po të ndodheshin në rrethana tjera normale që nuk do të kërkonin një urgjencë të tillë, ai vet do të kishte propozuar kthimin e projektligjit Qeverisë. Kjo për arsye se si propozimi i qeverisë së kaluar, ashtu edhe ky projektligj i qeverisë së tanishme nuk i përmbushë kriteret dhe kërkesat që decidivisht janë të përcaktuara në nenin 19 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Këto kërkesa janë që propozimi i Buxhetit nga ana e qeverisë duhet të përmbajë gjithsesi 9 dokumente, të cilat janë: Deklarata për projektligjin e Buxhetit nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Përmbledhjen e Buxhetit, Planin e të Hyrave dhe Shpenzimeve, Informacionet rreth Pasurisë dhe Detyrimeve, Propozimin e Ligjit vjetor mbi dispozitat e profitit të entiteteve të caktuara, Propozimin vjetor të Ligjit mbi Ndarjet e Buxhetit, Shpenzimet e përkushtuara dhe Planifikuara, Deklaratën e Misionit dhe Planin e Performancës, dhe Planin e Shpenzimeve Kapitale

Projektligji i buxhetit i pranuar nga Kuvendi përfshinë vetëm Propozimin vjetor të Ligjit mbi Ndarjet e Buxhetit dhe një pjesë të vogël të Planit të të Hyrave dhe Shpenzimeve. Si rezultat i kësaj, projektligji për buxhet është në të vërtetë një përmbledhje e tabelave të ndarjes që tregojnë shpenzimet e buxhetit të të gjitha Organizatave Buxhetore, përfshi këtu të gjitha komunat, për vitin fiskal vijues dhe vlerësimet për disa shpenzime për vitet fiskale 2009-10. Kjo e pengon qëllimin e

kërkesave të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë që këto tabela të ndarjes duhet të mbështeten me të gjitha informacionet dhe analizat e përmendura në nenin 19, të cilat do të justifikonin këto shpenzime një njëri anë, dhe në anën tjetër mundësojnë Kuvendit ti vlerësojë dhe përdorë ato në vendim-marrjen e tij.

Megjithatë, pasi që ky projektligj nuk ndryshon shumë nga versioni i qeverisë së kaluar, të cilin deputetët e mandatit të kaluar kanë pasur mundësi ta kenë dhe ta analizojnë, prapë kërkoi nga deputetët që në mënyrë të përshpejtuar ta shqyrtojnë dhe miratojnë projektligjin për buxhetin.

Pas komenteve dhe diskutimeve të bëra nga anëtarët e Komisionit, ato propozime dhe vërejtje të cilat hasën në përkrahje dhe mirëkuptim nga shumica a anëtarëve ishin :

Hajdin Abazi u shpreh i pakënaqur me kohën e shkurtër të lënë në dispozicion deputetëve për shqyrtim, kur edhe materialet u janë ofruar me shumë vonesë e disa edhe në ditën e shqyrtimit dhe kjo situatë krijon një pasiguri të deputetët edhe gjatë marrjes së vendimit. Ai kërkoi që herëve tjera materialet të merren me kohë dhe gjithashtu edhe tu lihet kohë e mjaftueshme për shqyrtim.

Haki Shatri kërkoi që në asnjë mënyrë të mos shkelet procedura e miratimit të projektligjit për Buxhetin, procedurë e cila kërkon procedimin e projektligjit për buxhetin në dy lexime në seancë plenare dhe e cila procedurë është garantuar edhe me Kornizën Kushtetuese. Ai propozoi që komisioni të punojë me një intensitet të shtuar dhe të përgatiten amendamentet të cilat do të propozohen në seancë plenare dhe që shqyrtimi në seancë plenare të bëhet me dy lexime, nëse është nevojshme edhe brenda një dite të mbahen dy seanca, por gjithsesi të kalohet përmes dy leximeve të projektligjit.

Myrvete Pantina kishte vërejtje tek të dhënat për të hyrat tatimore, që sipas saj 61 % e të hyrave që mbledhen në kufi, tregojnë për një ekonomi të ulët të vendit. Gjithashtu ishte kundër që KEK-ut ti jepen nga Buxheti i Konsoliduar kredi prej 79 milion euro. Ajo ishte e mendimit që buxheti nga Qeveria ishte dashur të ndahej në mënyrë më racionale dhe sipas prioriteteve.

Armend Zemaj kishte vërejtje sa i përket ndarjeve buxhetore që janë bërë nga Qeveria për institucionet dhe autoritet që kanë angazhim dhe përgjegjësi të lartë, siç është Administrata Tatimore e Kosovës (ATK). Ai nuk pajtohet me ndarjet buxhetore që i janë bërë ATK-së, sidomos kur dihet se ky institucion siguron dhe ka përgjegjësinë e mbledhjes së përqindjes më të madhe të të hyrave buxhetore, që janë të hyrat nga tatimet. Kjo për të duhet të paraqet prioritet sepse qeveria duhet të jetë e interesuar që mbledhja e tatimeve të jetë efikase, e gjithsesi të mos lejohet korrupsioni i inspektorëve tatimorë. Ai propozoi që të stimulohen punëtorët e ATK-së, sidomos inspektorët që mbledhin tatimet.

Besa Gaxherri u shpreh e pakënaqur me mënyrën e përshpejtuar të shqyrtimit, sidomos kur materialet as nuk janë shfletuar mirë nga deputetët, sepse janë marrë një ditë para mbledhjes dhe gjatë mbledhjes. Mirëpo për të më shqetësuese është fakti që çdo vit përsëritet e njëjta situatë sa i përket dorëzimit të projektligjit për buxhet nga Qeveria, çdo herë me vonesë dhe me presion që të kalohet propozimi sipas Qeverisë dhe nuk i lejohet Kuvendit që mirëfilli të shqyrtojë dhe amendamentojë projektligjin për buxhetin. Më e keqja që ndodhë sipas znj. Gaxherri është se gati në secilin vit është përsëritur situata kur Kuvendi ka marrë vendim për buxhetin e agjencioneve të pavarura dhe amendamente tjera, e të cilat më pas janë ndryshuar nga PSSP-ja dhe ligji i shpallur ka pësuar ndryshime nga ai që është miratuar në Kuvend. Znj. Gaxherri kishte vërejtjeve të neni 10.2 i projektligjit sa i përket transfereve që lejohen nga ministri për ekonomi dhe financa pas miratimit nga Qeveria dhe PSSP për projektet kapitale nga njëri projekt në tjetrin brenda një organizate buxhetore. Ajo gjithashtu kishte vërejtje për Qeverinë se premtimet të cilat janë bërë gjatë fushatës elektorale për rritje të buxhetit dhe pagave nuk janë përfillur ose të paktën nuk vërehen në propozim.

Edhe znj. Gaxherri propozoi që të favorizohen inspektorët e ATK-së, sa i përket pagave të tyre. Me gjithë vërejtjet dhe pakënaqësitë lidhur me mënyrën e shqyrtimit të projektligjit për Buxhetin 2008, ajo ishte e mendimit që i njëjti të kalohet në komision për hir të situatës aktuale të paraqitur.

Xhevdet Neziraj bëri të ditur mos pajtimin e tij lidhur me ndarjet buxhetore në nivel komunal. Sipas tij, që 8 vite është e njëjta situatë, kur një numër i konsiderueshëm komunash diskriminohen në aspektin buxhetor, kurse të tjerat privilegjojnë pa ndonjë kriter real, por në bazë të numrit të popullsisë i cili gjithashtu nuk është numër i saktë, sepse nuk është bërë regjistrimi i popullsisë. Për të, komuna e Pejës në vazhdimësi është e diskriminuar me ndarjen buxhetore që i bëhet asaj në krahasim me komunën e Prizrenit, edhe pse që të dy këto komuna janë në një pozicion të ngjashëm sa i përket popullsisë dhe zhvillimit. Z. Neziraj gjithashtu kërkoi që të bëhet përmirësim te ndarjet buxhetore për Ministrinë e Bujqësisë, sepse sipas tij për qeverinë aktuale duhet të jetë prioritet stimulimi i bujqësisë, një veprimtari e cila i duhet shumë Kosovës dhe duhet të zhvillohet më shumë.

Safete Hadergjonaj propozoi që komisioni të ndalet fillimisht në shqyrtimin e pjesës tekstuale të projektligjit, e pastaj në atë tabelare, me qëllim të kursimit të kohës së paktë që Komisioni ka në dispozicion për një shqyrtim të mirëfilltë që kërkon ky projektligj. Sipas saj ka mjaft vërejte në projekt buxhet dhe nevojë për sqarime, por kërkesa e saj ishte që Komisioni të fokusohet me shumë tek ndarjet buxhetore për agjencionet e pavarura, e sidomos te kërkesat e atyre agjencioneve të cilat fare nuk kanë kaluar përmes Qeverisë dhe i mbetet Kuvendit që të miratojë buxhetin e tyre i cili pastaj do të bëhet pjesë e Buxhetit të Konsoliduar. Këto janë dy agjencione, Zyra e Rregullatorit të Energjisë dhe Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit.

Znj. Hadergjonaj gjithashtu kërkoi që Komisioni të mos shqyrtojë e aq më pak të miratojë buxhetin e këtyre dy agjencioneve, pa praninë e përfaqësuesve të tyre në mbledhjen e komisionit dhe pa sqarimet dhe arsyetimin e kërkesave të tyre.

Agim Krasniqi, Drejtor i Buxhetit në MEF, propozoi për anëtarët e komisionit që gjatë shqyrtimit të pjesës tabelore të projektligjit të propozojnë amendament lidhur me harmonizimin e tabelës 2 dhe 4 në linjën “Fillimi i shpronësimit për ndërtimin e Autostradës Morinë – Merdarë

Pas diskutimeve dhe komenteve nga anëtarët e komisionit, anëtarët propozuan dhe miratuan me shumicë votash amendamentet në vijim për projektligjin:

Amendamentet në pjesën tekstuale

Amendamenti 1

Të harmonizohen versionet në gjuhën serbe dhe angleze me versionin në gjuhën shqipe.

Amendamenti 2

Në tërë tekstin e Projektligjit, ku përmenden fjalët “**Rregullores së tanishme**” e që mendohet në këtë Ligj, të zëvendësohen me fjalët në vijim: “**Ligjit të tanishëm**”

Amendamenti 3

Preambula e projektligjit ndryshon si në vijim:

Ligji nr. 03/L-013

Mbi miratimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën prej 1 janarit deri më 31 dhjetor të vitit 2008

Kuvendi i Kosovës,

Duke pasur parasysh përgjegjësitë e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes sipas neneve 5.1 (a) dhe (b) dhe nenit 5.2 (c) të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2001/9 të datës 15 maj 2001 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,

Duke marrë parasysh shtojcën II të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 për “Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë”,

Duke marrë parasysh Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 23 janar 2003 (Ligji nr. 2003/2) i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/17 të datës 12 maj 2003,

Me qëllim të miratimit të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe çështjeve të tjera të lidhura me të,
Nxjerrë këtë:

Amendamenti 4

Neni 4.7.

Në fund të paragrafit, pas fjalëve “Udhëzimin Administrativ mbi Ndarjen e drejtë të financimit për Komunitetet “ të shënohet numri dhe data nr.2006/09

Amendamenti 5

Neni 6.12.

Në fjalinë e parë pas fjalës “Kuvendi” fshihen fjalët “dhe PSSP-ja”

Amendamenti 6

Neni 14

Riformulohet si në vijim:

Ky Ligj hyn në fuqi pas miratimit në Kuvendin e Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm

Ligji nr. 03/I-013

XX shkurt 2008

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Jakup Krasniqi

Amendamentet në pjesën tabelare

Amendamenti 8

Të harmonizohet tabela 2 dhe 4 në linjën “Fillimi i shpronësimit për ndërtimin e Autostradës Morinë – Merdarë.

Pas miratimit të amendamenteve të Komisionit lidhur me projektligjin, Kryetari propozoi që Komisioni të sjellë konkluzion lidhur me mënyrën e procedimit të Projektligjit për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2008.

Pas votimit, më shumicë votash Komisioni mori këtë

K O N K L U Z I O N

Komisioni ka shqyrtuar paraprakisht dhe ka amendamentuar Projektligjin për miratimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën prej 1 janarit deri më 31 dhjetor të vitit 2008, dhe është i gatshëm të veprojë ashtu siç vendos Kuvendi për mënyrën e procedimit të tij.

Më pas Kryetari hapi për shqyrtim pikën e katërt të rendit të ditës

4. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të organizatave buxhetore në vijim:

4.1. Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit, 4.2. Zyra e Rregullatorit të Energjisë 4.3 Agjencioni Kosovar kundër Korrupsionit, 4.4. Këshilli Gjyqësor i Kosovës, 4.5. Instituti Gjyqësor i Kosovës, 4.6. Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina, 4.7. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, 4.8. Komisioni i Pavarur për Media, 4.9. Agjencia Pyjore e Kosovës, 4.10. Institucioni i Ombudspersonit, 4.11. Ministria për Komunitete dhe Kthim, 4.12. Zyra për komunitete e komunës së Zveçanit, 4.13. Ministria për Tregti dhe Industri, 4.14. Ministri për Punë të Brendshme, 4.15. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës, 4.16. Shqyrtimi i kërkesës për projektet kapitale për vitin 2008 të Kuvendit të Kosovës.

Për kërkesat e agjencioneve buxhetore për ndarje të buxhetit shtesë për vitin 2008, zv. Ministri z. Bedri Hamza dhe drejtori i Buxhetit z. Agim Krasniqi sqaruan para anëtarëve të Komisionit, se Qeveria e tanishme me rastin e rishikimit të propozimit për Buxhetin 2008 të përgatitur nga qeveria e kaluar, i ka marrë parasysh të gjitha kërkesat e organizatave të cilat janë bërë deri në ato kohë dhe ato më të arsyeshmet dhe me prioritare i ka përfshirë në versionin e përcjellur Kuvendit. Në këto kërkesa të shqyrtuara nga ana e qeverisë përfshihen kërkesat nga organizatat buxhetore të propozuara në rend dite, respektivisht pikat 4.3 - 4.15.

Z. Bedri Hamza dhe z. Agim Krasniqi rekomanduan për komisionin që kërkesat të cilat nuk janë miratuar nga Qeveria në këtë fazë të mos shqyrtohen në Komision, por të lihen që për to të merret vendim gjatë periudhës së rishikimit të Buxhetit, proces i cili ndodh në muajin qershor të çdo viti fiskal.

Kërkesat nga pikat 4.1 dhe 4.2, respektivisht kërkesat e ART dhe ZRRë nuk janë parashtruar fare pranë Qeverisë dhe i mbetet Komisionit të shqyrtojë kërkesat e tyre dhe ti propozojë Kuvendit të marrë vendim për buxhetet e këtyre agjencioneve, të cilat buxhete më pas do të bëhen pjesë s Buxhetit të Konsoliduar.

Gjithashtu kërkesa nën pikën 4.16 (Kuvendi i Kosovës) nuk është parashtruar në Qeveri, mirëpo z. Krasniqi sqaroi se kjo kërkesë është e arsyeshme dhe pjesërisht mund të miratohet dhe përfshihet në Buxhet në këtë fazë pasi që projektet për të cilat kërkohet ridestininim i mjeteve, veç janë projekte që edhe në vitin 2007 figurojnë në PIP (Programi i Investimeve Publike). Kjo e bën më të lehtë miratimin e kësaj kërkesë pasi që të gjitha projektet të cilat janë përfshirë në PIP janë të planifikuara, kanë strukturën, koston dhe çdo informacion që është i nevojshëm për zbatimin e tyre. Përderisa për pjesën tjetër të kërkesës lidhur me lejimin e mjeteve për paga dhe mëditje ai propozoi të shqyrtohet gjatë rishikimit të Buxhetit në muajin qershor, sikurse kërkesat e organizatave tjera buxhetore

Kërkesa e Kuvendit që të ridestinohej mjetet nga Projekti ‘Vila Gërmia’ në projekte tjera të propozuara pranë Komisionit u sqarua dhe arsyetua nga **sekretari i Kuvendit z. Ismet Krasniqi**, sipas të cilit kjo kërkesë përmban projekte prioritare për Kuvendin e Kosovës dhe mund të realizohet në këtë vit.

Besa Gaxherri u shpreh kundër miratimit të tanishëm të kërkesës së Sekretarisë së Kuvendit të Kosovës për ridestinim të mjeteve për projekte kapitale. Ajo propozoi që kjo kërkesë të lihet për më vonë dhe kërkoi që të respektohet vendimi i vitit të kaluar i Kuvendi të Kosovës për vazhdimin e punimeve në projektin ‘Vila Gërmia’.

Pas diskutimeve dhe komenteve nga ana e anëtarëve të Komisionit, anëtarët u pajtuan që kërkesat për buxhet shtesë për vitin 2008 të parashtruara nga organizatat buxhetore janë të mangëta sa i përket arsytimit, planifikimit dhe kostos së tyre. Gjithashtu disa kërkesa fare nuk bien në përgjegjësi të komisionit dhe Kuvendit të vendosë për to, pasi që rregullat ligjore parashohin që buxheti për disa nga agjencionet të kalojë përmes ministrive përkatëse.

Anëtarët u pajtuan që për këto kërkesa komisioni të merret brenda një kohe të mjaftueshme për të analizuar dhe shqyrtuar, e kjo të lihet në periudhën e rishikimit të buxhetit gjatë muajit qershor.

Kryetari ftoi anëtarët që të deklarohen përmes votimit lidhur me kërkesat nga pika 4 e rendit të ditës.

Me shumicë votash u miratua rekomandimi në vijim:

REKOMANDIM

1. Në mungesë të kohës së mjaftueshme për shqyrtim dhe marrje të vendimit, Komisioni i rekomandon Kuvendit që kërkesat buxhetore të organizatave buxhetore në vijim për ndarje të shtesë të buxhetit në Buxhetin e Konsoliduar për vitin 2008, të merren parasysht për shqyrtim gjatë procesit të rishikimit të Buxhetit të Konsoliduar në gjashtëmujorin e parë të vitit fiskal 2008:

- 1.1 Agjencioni Kosovar kundër Korrupsionit
- 1.2 Këshilli Gjyqësor i Kosovës
- 1.3 Instituti Gjyqësor i Kosovës
- 1.4 Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina
- 1.5 Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
- 1.6 Komisioni i Pavarur për Media
- 1.7 Agjencia Pyjore e Kosovës
- 1.8 Institucioni i Ombudspersonit
- 1.9 Ministria për Komunitete dhe Kthim
- 1.10 Zyra për komunitete e komunës së Zveçanit
- 1.11 Ministria për Tregti dhe Industri
- 1.12 Ministri për Punë të Brendshme
- 1.13 Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës

2. Të obligohet Qeveria që në procesin e rishikimit të Buxhetit të Konsoliduar në gjashtëmujorin e parë të vitit fiskal 2008 të veprojë në pajtim me këtë Rekomandim dhe në të njëjtën kohë t'i mundësojë Komisionit për Buxhet dhe Financa rol aktiv në këtë proces buxhetor.

Me votat 8 për dhe 1 kundër (znj. Besa Gaxherri) u miratua amendamenti në vijim:

Amendamenti 9

Në tabelën 4, kodi i programit 101 – Kuvendi , nga kodi i projektit 001-102, PIP Kodi 101001-06448 – Vila Gërmia merret shuma prej 390.000 euro dhe e njëjta destinohet në të njëjtin kod por për projektet e dorëzuara dhe miratuara në Komision.

Anëtarët e Komisionit vendosën që për shqyrtimin e kërkesave nga pikat 4.1 (kërkesa e ART) dhe 4.2 (kërkesa e ZRrE) të rendit të ditës, të ftohen përfaqësuesit e këtyre agjencioneve dhe të kërkojnë nga ta informata dhe arsyetime shtesë lidhur me kërkesat e tyre. Shqyrtimi i këtyre kërkesave u shty për mbledhjen e ardhshme.

Mbledhja e ardhshme u caktua për datën 14.02.2008 (e enjte) prej orës 13:00.

Mbledhja përfundoi në ora 15:30
Shërbimi i komisioneve

Kryetari i Komisionit

Gani Koci